

Pyetjet më të shpeshta

Pyetje: Për organizatat jofitimprurëse që kanë kaluar ne Status Pasiv a aplikohet ligji?

Përgjigje: Detyrimi i regjistrimit të pronarit përfitues, e ka çdo subjekt raportues, pavarësisht statusit të tij.

Pyetje: Kush mund te regjistrohet si pronar i OJF-s?

Përgjigje: Pronar përfitues i organizatave jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse, është:

- Themeluesi ose
- përfaqësuesi ligjor ose
- individi që ushtron kontrollin e fundit efektiv në administrimin dhe kontrollin e organizatave jofitimprurëse.

Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia në të cilën një person:

-përcakton vendimet e marra nga organizata jofitimprurëse;

-kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen, emërimin dhe largimin e shumicës së organeve vendimmarrëse dhe/ose organeve ekzekutive të organizatës jofitimprurëse

Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit

3 ditë pune

Periudha e vlefshmërisë

1-vjeçare për profilet: Profesionist i lirë, Profesionist i punësuar, Administrator dhe Drejtues Teknik.

1-javore për Nënshkrimin Elektronik 1 javor

Kostot

4800 lekë për profilet: Profesionist i lirë, Profesionist i punësuar, Administrator dhe Drejtues Teknik

([Shkarkoni faturën](#))

Pa pagesë për Nënshkrimin Elektronik 1 javor.

Më shumë

Për çdo pyetje apo paqartësi mbi përdorimin e shërbimit mund të kontaktoni në adresën helpdesk@e-albania.al ose vizitoni <https://akshi.gov.al/nenshkrimi-elektronik-per-subjektet-private/>



Pyetje: Formulari i aplikimit eshte i njejte per te gjitha subjektet raportuese. Termat pronar, pronesi direkte/indirekte, kuota etj. nuk korrespondojne me natyren juridike te OJF. Kjo krijon problem gjate plotesimit te aplikimit per keto subjekte, i cili nuk validohet lehtesisht

Përgjigje: Referuar natyrës së ndryshme të një OJF-ve nga subjektet tregtare dhe identifikimit të pronarit të tyre përfitues i cili sipas ligjit është I ndryshëm; formularët e aplikimit janë hartuar në dy lloje: për OJF dhe subjekte tregtare.

Pyetje: Çfarë nënkupton deklarata me shkrim e themeluesit te OJF ose presidentit, kur pozicioni i tij është i mirepërcaktuar në statutin e vete shoqatës?

Përgjigje: Referuar VKM nr. 1088/2020, deklarata me shkrim e përfaqësuesit ngarkohet në rast se pas shterimit të të gjitha mjeteve të mundshme për identifikimin e pronarit përfitues dhe nëse nuk ka arsye për dyshime, subjektet raportuese nuk arrijnë të identifikojnë si pronar përfitues individin i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit një person juridik, përmes pronësisë direkte ose indirekte të 25% ose më tepër të aksioneve/kuotave të kapitalit ose të interesave të pronësisë në një subjekt raportues sipas përcaktimeve të ligjit “Për regjistrin e pronarëve përfitues”. Pra, është një akt që nuk përcakton pozicionin e tij në subjektin raportues, por hapat që ai ndërmerr për identifikimin e pronarit përfitues si dhe arsyet e identifikimit të personit të regjistruar si pronar përfitues.

